



ÇFARË NDODH PAS 6 VOTAVE TË LDK-së KUNDËR KANDIDATURËS SË BEKIM SEJDIUT PËR PRESIDENT?

I PAGE 4-5



Marrëveshja në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për zgjedhjen e presidentit të ardhshëm të Kosovës është refuzuar nga gjashtë deputetë të

LDK-së, duke ngritur pikëpyetje nëse ajo mund ta prodhojë kreun e ri të shtetit. Pavarësisht prej kundërshtisë nga gjashtë deputetë, kreu i LV-së, Albin Kurti, tha se marrëveshja me partinë e Lumir

Abdixhiku qëndron dhe është e vlefshme. Por për Donika Eminin, hulumtuese në Grupin Këshillues për Politikën e Ballkanit në Evropë (BiEPAG), ky konfigurim politik më nuk mjafton

SVEÇLA SHPALLET FAJTOR PËR HEDHJE TË GAZIT LOTSJELLËS NË KUVEND F. 7



PËRFAQËSUESIT E MBI 100 MIJË STUDENTËVE PARALAJMËROJNË BE-NË: NUK JU LEJOJMË TË NA E KRIMINALIZONI LUFTËN E UÇK-së F. 3



RENOVA
Maqedoni
Xhëpçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji biznesi.com
info@kolegji biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Peshko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



HAXHIU LIRON NGA DETYRA 18 GJYQATARËT SERBË QË DHANË DORËHEQJE MË 2022 F. 2

RRITET PËR 83.3 % NUMRI I RASTEVE TË RAPORTUARA PËR TË SHTËNAT FESTIVE KRAHASUAR ME PERIUdhËN E VITIT TË KALUAR F. 6

LIMAJ: NË KOSOVË ME LEGJITIMITET JANË VETËM KRYETARËT DHE ASAMBLTË KOMUNALE, POSTET E TJERA PA LEGJITIMITET F. 6

EKONOMI



AUDITORJA E PËRGJITHSHME: FORCIMI I LLOGARIDHËNIES DHE RRIJTA E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE DUHET TË JENË PRIORITETE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE F. 8

SPORT



INAUGUROHET ZYRTARISHT 'FIFA TALENT ACADEMY KOSOVA', NJË HAP I MADH PËR ZHVILLIMIN E TALENTEVE TË RINJ F. 11

HAXHIU LIRON NGA DETYRA 18 GJYQTARËT SERBË QË DHANË DORËHEQJE MË 2022

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ushtresja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, njoftoi se ka liruar nga detyra 18 gjyqtarë serbë që kanë dhënë dorëheqje në vitin 2022. Këtë vendim ajo e mori pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), i cili më 27 gusht vendosi për kërkesën e gjyqtarëve serbë të cilët kishin kërkuar të tërhiqnin vendimin e dorëheqjes.

Vendimi për lirimin nga detyra të gjyqtarëve serbë vjen pasi Haxhiu në korrik liroi nga detyra

shtatë prokurorë serbë që kishin dhënë dorëheqje më 2022.

Rreth 130 gjyqtarë, prokurorë dhe punonjës administrativë të sistemit të drejtësisë, kishin dhënë dorëheqje në fund të nëntorit 2022, në kuadër të largimit kolektiv të serbëve nga institucionet e Kosovës në katër komunat me shumicë serbe në veri - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok.

Ky veprim - i nxitur nga Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, që



mbështetet nga Beogradi - erdhi në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i hequr nga përdorimi targat e automjeteve të lëshuara nga Serbia dhe për t'i

zëvendësuar ato me targa të Kosovës.

BE-j ka kërkuar që çështja e riintegritit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të dorëhequr serbë të zgjidhet në kuadër të dialogut mes dy vendeve fqinje, por Kosova dëshiron t'i lirojë ata nga detyra dhe t'i plotësojë vendet e tyre përmes konkurseve të reja për gjyqtarë dhe prokurorë serbë. Pas vendimit të KGJK-së për ta refuzuar kërkesën për tërheqjen e dorëheqjeve, BE-ja reagoi duke shprehur "keqardhje të thellë".

"Këto vendime duket se nuk janë

në përputhje me ligjet në Kosovë, me proceset e rregullta dhe me kërkesat e përgjithshme për sundimin e ligjit në Kosovë", tha një zëdhënës i BE-së, duke iu referuar vendimeve të KGJK-së dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, organe që refuzuan kërkesat për tërheqjen e dorëheqjeve.

Autoritetet e Kosovës kanë ngulur këmbë se rikthimi i serbëve në institucionet e Kosovës nuk mund të jetë çështje politike, por duhet të trajtohet si çështje juridike dhe kushtetuese.

LIGJVËNËSIT AMERIKANË SHQYRTOJNË LIDHJET E RUSISË DHE KINËS ME REBELËT HUTHI

Uashington, 2 shtator - Irani mbetet mbështetësi kryesor i huaj i rebelëve Huthi, por Rusia dhe Kina po tërheqin gjithnjë e më shumë vëmendjen në Uashington për shkak të lidhjeve të tyre me grupin militant jemenas.

Në një seancë më 1 shtator të Nënkomisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, ligjvënësit dhe ekspertët u përqendruan te zgjerimi i lidhjeve operative, të inteligjencës dhe të prokurimit të rebelëve Huthi me Moskën dhe Pekinin.

Seanca, e zhvilluar pasi Kongresi amerikan u rikthye nga pushimi veror, riktheu vëmendjen te rrjetet rajonal i Teheranit dhe roli në rritje i fuqive të tjera që mbështesin grupin rebel jemenas.

Rebelët kontrollojnë pjesën më të madhe të Jemenit verior, përfshirë kryeqytetin Sana, pas më shumë se një dekadë lufte civile kundër forcave që mbështesin Qeverinë e njohur ndërkombëtarisht. Arabia Saudite ndërhyri kundër grupit në vitin 2015, por luftimet në shkallë të gjerë u reduktuan pas një armëpushimi të ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2022, por pa një marrëveshje të qëndrueshme politike.

Kjo qetësi e brishtë është vënë sërish nën tryzni në vitin 2026, me rebelët Huthi dhe Arabinë Saudite që kanë rifilluar sulmet e ndërsjella, teksa përplasjet më të gjera mes Shteteve të Bashkuara dhe Iranit po përhapen edhe në Jemen dhe në Detin e Kuq. OKB-ja ka paralajmëruar për rikthim të konfliktit në shkallë të gjerë.

"Objektiva ekspansioniste"

Ligjvënësit amerikanë e pyetën panelin se si përfshirja e Moskës dhe Pekinit në Lindjen e Mesme lidhet me një fushatë më të gjerë kundër interesave perëndimore. Ligjvënësi Joe Wilson (republikan nga Karolina e

Jugut) e paraqiti kërcënimin e rebelëve Huthi si pjesë të një sfide më të gjerë nga shtetet autoritare. "Rebelët Huthi kanë objektiva ekspansioniste, të nxitura ideologjikisht, të cilat shtrihen përtej Jemenit", tha Wilson, duke shtuar se grupi po ndërton rrjete me "grupe terroriste dhe kundërshtarë shtetërorë të ShBA-së, si kriminelitë i luftës [presidenti rus, Vladimir] Putin, dhe Partia Komuniste Kineze".

Wilson i lidhi këto raporte me pushtimin rus të Ukrainës dhe sulmet e mbështetura nga Irani në Lindjen e Mesme. "Ne jemi në një luftë, besoj, që nuk e zgjodhëm dhe që është një luftë e diktatorëve që qeverisin me forcën e armës, duke pushtuar demokracitë që qeverisin me sundimin e ligjit", tha ai.

Wilson përmendi po ashtu përdorimin nga militantët jemenas të "dronëve nënujorë shumë të sofistikuar, të cilët rebelët Huthi nuk do të kishin mundur t'i zhvillonin vetë", si dëshmi të mbështetjes së drejtpërdrejtë nga kundërshtarë të huaj.

"Një raport që po evoluon"

Nadwa Al-Dawsari, eksperte për Jemenin dhe bashkëpunëtoreshë në Institutin e Lindjes së Mesme, u tha ligjvënësve amerikanë se "ka pasur disa dëshmi se rebelët po ndërtojnë lidhje me Rusinë dhe Kinën".

Sulmet e rebelëve jemenas ndaj anijeve në Detin e Kuq dhe përreth tij janë përshkallëzuar javët e fundit, përfshirë sulmet ndaj anijeve që kalojnë në Ngushticën e Bab el-Mandebit, një pikë kyç që lidh Detin e Kuq me Gjirin e Adenit. Përshkallëzimi vjen teksa konflikti ShBA - Iran ka shkaktuar pengesa në transportin detar përmes Ngushticës së Hormuzit, një tjetër rrugë kryesore për tregtinë globale.

Al-Dawsari iu referua raporteve se operative rusë ndodheshin në Sana, duke ndihmuar rebelët Huthi në shënjestrimin e anijeve

në Detin e Kuq "me informacione dhe mbështetje teknike".

Ajo po ashtu iu referua vlerësimeve të zyrtarëve amerikanë se një kompani satelitore, e lidhur me ushtrinë kineze, kishte ofruar informacione të inteligjencës duke ndihmuar rebelët jemenas për sulmet ndaj luftanijeve amerikane dhe anijeve tregtare. Al-Dawsari tha se dokumentet e Departamentit amerikan të Thesarit tregonin se armë, komponentë me përdorim të dyfishtë, si dhe pjesë për dronë dhe raketa ishin siguruar për rebelët Huthi nga Kina dhe Rusia. Ajo tha po ashtu se të dyja fuqitë u kishin ofruar mbrojtje diplomatike në Kombet e Bashkuara, duke abstenuar në rezolutat e Këshillit të Sigurimit që dënonin sulmet detare të rebelëve jemenas. "Pra, ekziston një raport dhe ai po evoluon", tha Al-Dawsari, duke shtuar se partneriteti synon të zgjerojë ndikimin rus dhe kinez në rajon "në dëm të Shteteve të Bashkuara".

Kina si qendër e prokurimit

Kryetari i Nënkomisionit, Mike Lawler (republikan nga Nju Jorku), e pyeti Al-Dawsarin për rrjetet ndërkombëtare që lehtësojnë sigurimin e financave dhe armëve nga grupi militant jemenas.

Duke sqaruar se nuk ishte specialiste për financimin e terrorizmit, Al-Dawsari dha një vlerësim të drejtpërdrejtë për zinxhirin e furnizimit me armë, duke thënë se "shumica e kontrabandës së armëve për rebelët Huthi kalon përmes kompanive kineze".

Ajo i bëri thirrje Uashingtonit t'i bëjë presion Pekinit që të shënjestrojë kompanitë private kineze që lehtësojnë transferimin e armëve.

Al-Dawsari theksoi se, ndonëse sanksionet amerikane kanë goditur financat formale të grupit, rebelët jemenas ende gjenerojnë rreth 2 miliardë dollarë në vit nga tregtia e paligjshme e naftës dhe

mbështeten në një "rrjet të gjerë kontrabande" për të rigjeneruar kapacitetet e tyre ushtarake.

Lidhjet me Rusinë dhe autonomia e rebelëve Huthi

Allison Minor, drejtoreshë e Projektit për Integrimin në Lindjen e Mesme në Këshillin e Atlantikut, tha në fjalën e saj në Kongres se sulmet ushtarake amerikane dhe izraelite "kanë kontribuar në bashkëpunimin e ri mes rebelëve Huthi dhe Rusisë".

Por, ajo paralajmëroi se vetëm ndërhyrja ushtarake nuk do ta eliminonte kërcënimin. "Realiteti është se rebelët Huthi lulëzojnë në një mjedis lufte, veçanërisht në një mjedis të karakterizuar nga ndërhyrja e huaj", u tha ajo anëtarëve të panelit.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të ligjvënësit Rob Zinke (republikan nga Montana) lidhur me zinxhirin komandues të grupit, Minor theksoi se ndonëse Teherani ka "ndikim të madh", udhëheqësi i rebelëve Huthi, Abdul-Malik al-Houthi, ka fjalën e fundit sa i përket vendimmarrjes. "Unë do të argumentoja se rebelët Hithi janë edhe më të rrezikshëm se një përfaqësues iranian", tha Minor. "Ata kanë ambicie të mëdha dhe ndonjëherë kanë dëshmuar se janë më të pamatur në ndjekjen e këtyre ambicieve nga sa do të prisnim edhe ne". Ajo shtoi se aparati ushtarak dhe i inteligjencës i grupit është shumë më i fuqishëm se krahut i tij politik.

Debati mbi strategjinë

Seanca në Dhomën e Përfaqësuesve vuri në pah debatin e fortë mbi mënyrën se si Uashingtoni duhet t'i përgjigjet kërcënimit të grupit militant.

Anëtar i ri kryesor i opozitës në nënkomision, ligjvënësi Jared Moskowitz (demokrat nga Florida), i pyeti pjesëmarrësit se çfarë alternativash kishte



Uashingtoni nëse ndërhyrja ushtarake dhe sanksionet ekonomike do të dështonin.

Al-Dawsari bëri thirrje për mbështetje më të madhe nga ShBA-ja dhe vendet e rajonit për forcat e qeverisë jemenase. "ShBA-ja duhet të shqyrtojë mundësinë e armatosjes dhe trajnimit të forcave jemenase në bashkëpunim me Arabinë Saudite", tha ajo, duke argumentuar se ndihma për forcat legjitime për të rimarrë territorin do t'u hiqte rebelëve të ardhurat, pikat e nisjes së sulmeve dhe rrugët e kontrabandës detare.

Ligjvënësi Brad Schneider (demokrat nga Illinoisi) ngjashëm ngriti shqetësime për shmangien e një angazhimi ushtarak amerikan, duke e kufizuar në mënyrë efektive grupin.

Minor, ndërkaj, paralajmëroi kundër përfshirjes më të thellë ushtarake të ShBA-së. "Lufta në Jemen nuk është luftë e ShBA-së dhe ne nuk duhet ta bëjmë tonën", tha ajo duke bërë thirrje që presioni ushtarak amerikan të lidhet me një strategji më të gjerë politike, krahas angazhimit të qëndrueshëm diplomatik dhe riemërimit të një të dërguari të posaçëm amerikan për Jemenin.

Pavarësisht lidhjeve në zgjerim të rebelëve Huthi me Rusinë dhe Kinën, roli i Iranit ishte në fokus të seancës.

Al-Dawsari tha se komandantë të Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC) kishin udhëtuar në Jemen për t'i përgatitur rebelët për sulme. "Nëse lufta me ShBA-në vazhdon dhe presioni përmes Ngushticës së Hormuzit bëhet më pak i zbatueshëm për Iranin, mund të presim që rebelët Huthi të përshkallëzojnë veprimet në Detin e Kuq", paralajmëroi ajo.

PËRFAQËSUESIT E MBI 100 MIJË STUDENTËVE PARALAJMËROJNË BE-në: NUK JU LEJOJMË TË NA E KRIMINALIZONI LUFTËN E UÇK-SË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Përfaqësuesit e parlamenteve studentore të universiteteve publike në Kosovë, që përfaqësojnë mbi 100 mijë studentë, të mbështetura edhe nga përfaqësues të studentëve nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Ata në mënyrë të organizuar e kanë dorëzuar në Zyrën e BE-së edhe një Deklaratë të Përbashkët, ku kanë kërkuar që vendimi në Hagë për ish-udhëheqësit e UÇK-së të merret pa ndikime politike, pa standarde të dyfishta dhe vetëm mbi bazën e fakteve, provave, ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës. "Si gjeneratë e re e Kosovës, që edhe 27 vjet pas çlirimit ende përballet me procese dhe hetime ndërkombëtare për luftën e UÇK-së, përfaqësuesit e parlamenteve studentore kanë thënë se mënyra sesi është zhvilluar ky proces në Hagë, i mbështetur dhe financuar nga vendet e Bashkimit Evropian, ka krijuar te qytetarët tanë bindjen se i ka shërbyer më shumë narrativës dhe nevojave politike

përfaqësues të studentëve nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Deklarata e Përbashkët e parlamenteve studentore për BE-në, që u lexua para Zyrës së BE-së nga Endi Binaku, deputet në Parlamentin Studentor në UP:

"Ne, përfaqësuesit e studentëve të universiteteve publike, të indinjuar nga procesi gjashtëvjeçar në Hagë dhe nga padrejtësitë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe bashkëluftëtarëve të tyre, sot e ngremë zërin e studentëve edhe para jush, si Zyrë e Bashkimit Evropian në Kosovë. Si parlamente studentore që përfaqësojnë rreth 100 mijë studentë, kërkojmë që vendimi në Hagë të merret pa ndikime politike, pa standarde të dyfishta dhe vetëm mbi bazën e fakteve, provave, ligjit dhe Kushtetutës së Kosovës.

Ne jemi gjenerata e re e Kosovës, e një vendi që edhe 27 vjet pas çlirimit ende përballet me procese dhe hetime ndërkombëtare ndaj personaliteteve që lidhen drejtpërdrejt me luftën, lirinë, pavarësinë dhe shtetndërtimin e vendit tonë. Në të njëjtën kohë, Serbisë ia keni hapur rrugën



mëdha dhe të vazhdueshme për transparencën, paanshmërinë, trajtimin e barabartë dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut. Pas gati gjashtë vitesh, këto shqetësime janë ngritur edhe nga organizata prestigjioze ndërkombëtare që monitorojnë proceset gjyqësore dhe nuk mund të anashkalohen apo të heshten nga ju. Mënyra se si është zhvilluar ky proces, i mbështetur dhe financiar nga vendet e Bashkimit Evropian, ka krijuar te qytetarët tanë bindjen se ai i ka shërbyer më shumë narrativës dhe nevojave politike të Serbisë sesa kërimit të drejtësisë.

Për ne, si përfaqësues të

studentëve të shtatë universiteteve publike të Kosovës, shteti i së drejtës është vlerë themelore për të ardhmen demokratike të vendit tonë. Por shteti i së drejtës ka kuptim vetëm atëherë kur drejtësia është e njëjtë për të gjithë dhe kur standardet nuk ndryshojnë sipas rrethanave politike.

Ne nuk do të heshtim dhe nuk do të lejojmë që lufta për lirinë e Kosovës të reduktohet në një narrativë kriminalizuese dhe historia jonë të rishkruhet. Ne jemi gjenerata që e ka trashëguar këtë liri dhe do ta mbrojmë me çdo kusht të vërtetën tonë.

Drejtësia juaj nuk duhet të ketë një standard për Kosovën dhe

një tjetër për Serbinë.

Si gjeneratë e re e Kosovës, kërkojmë që zëri ynë të dëgjohej dhe shqetësimet tona të merren seriozisht.

Kërkojmë drejtësi dhe standarde që vlejnë njësoj për të gjithë dhe një Evropë që e trajton Kosovën me të njëjtin standard që kërkon nga ne.

Kosova po pret. Ne po presim. Më 16 shtator, presim që ish-udhëheqësit e UÇK-së dhe themeluesit e shtetit tonë të lirohen dhe të kthehen në Kosovë, pranë familjeve dhe në vendin e tyre.", përfundon Deklarata e Përbashkët e parlamenteve studentore të universiteteve publike në Kosovë".



të Serbisë sesa kërimit të drejtësisë.

Përfaqësuesit e parlamenteve studentore kanë thënë se nuk do të lejojnë që lufta për lirinë e Kosovës të reduktohet në një narrativë kriminalizuese dhe historia jonë të rishkruhet. Si gjeneratë që e ka trashëguar këtë liri, ata kanë thënë se do ta mbrojmë me çdo kusht të vërtetën për luftën çlirimtare", thuhet në deklaratën e përfaqësuesve të parlamenteve studentore të universiteteve publike në Kosovë, të mbështetura edhe nga

drejt integritetit evropian, pavarësisht të kaluarës së saj kriminale dhe përgjegjësisë për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, për të cilat ende nuk ka kërkuar as falje.

Si gjeneratë e lindur gjatë dhe pas luftës, e kemi parë nga afër se procesi gjyqësor në Hagë ka lënë pasojë të thella dhe e ka polarizuar shoqërinë tonë, duke ushqyer mosbesim dhe duke krijuar një ndjenjë të fortë padrejtësie te qytetarët e Kosovës.

Ajo që është paraqitur si drejtësi, për ne ka ngritur shqetësime të



Haradinaj merr dhuratë flamurin e UÇK-së nga OVLUÇK-ja

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Deputeti i Aleancës, Ramush Haradinaj, ka vizituar selinë e OVLUÇK-së. Ai ka treguar se gjatë

kësaj vizite ka pranuar nga udhëheqja e OVLUÇK-së flamurin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Pata kënaqësinë që sot të isha në

selinë e OVLUÇK-së, ku takova udhëheqjen e saj, në krye me kryetarin Hysni Gucatin. Me respekt pranova nga ta flamurin e

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Liri për Çlirimtarët. I presim në Kosovë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".





ÇFARË NDODH PAS 6 VOTAVE TË LDK-së KUNDËR KANDIDATURËS SË BEKIM SEJDIUT PËR PRESIDENT?

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Marrëveshja në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për zgjedhjen e presidentit të ardhshëm të Kosovës u refuzua nga gjashtë deputetë të LDK-së, duke ngritur pikëpyetje nëse ajo mund ta bëjë kreun e ri të shtetit. Pavarësisht prej kundërshtisë nga gjashtë deputetë, kreu i LV-së, Albin Kurti, tha se marrëveshja me partinë e Lumir Abdixhikut qëndron dhe është e vlefshme. Por, për Donika Eminin ky konfigurim politik më nuk mjafton. Emini, hulumtuese në Grupin Këshillues për Politikën e Ballkanit në Evropë (BiEPAG), thotë për Radion Evropa e Lirë se vendimi i gjashtë deputetëve të LDK-së për të mos e mbështetur Bekim Sejdiun - kandidatin e përbashkët të LV-së dhe LDK-së - për president, nënkupton se konfigurimi aktual s'i ka 80 deputetë që duhet të marrin pjesë në proces, duke bërë që të lindë nevoja për përfshirjen e partive të tjera në marrëveshjen për president. LV-ja ka 53 mandate, ndërsa LDK-ja aktualisht, sipas Abdixhikut, ka vetëm 12 deputetë që e mbështesin Sejdiun për president. Nëse llogariten edhe pakicat joserbe

- me të cilat Kurti bëri qeverinë e kaluar - sërish nuk arrihet kuorumi që Sejdiu të bëhet presidenti i gjashtë të Kosovës që nga pavarësia. Kurti ka kohë që refuzon votat e Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, që ka mbështetjen e Beogradit, e cila ka fituar nëntë mandate në zgjedhjet e qershorit. Partia Demokratike e Kosovës, ndërsa, ka 22 deputetë, ndërsaq Aleanca shtatë. "Për ta bërë [marrëveshjen] funksionale, duhet të zgjerohet me një partner tjetër, qoftë Aleanca apo PDK-ja. Por, kjo do të ishte një konfigurim krejtësisht i ri politik dhe do të sillte edhe një sërë sfidash të reja", thotë Emini. Prej muajsh, Aleanca e Ardian Gjinit ka paraqitur gjashtë kushte në këmbim të mbështetjes për institucionet, ndërsaq PDK-ja e Bedri Hamzës ka refuzuar që të bashkëpunojë me Kurtin, si për Qeverinë, ashtu edhe për presidentin, duke deklaruar se këtë mandat do të qëndrojë në opozitë. Vetëm LDK-ja e Lumir Abdixhikut pranoi të negocionte me Kurtin, fillimisht për bashkëqeverisje - proces që dështoi pas kërkesës fillestare të LDK-së për të pasur presidentin - dhe më pas për presidentin, që rezultoi me marrëveshjen e

31 gushtit. Atë ditë, LV-ja dhe LDK-ja dolën me kandidatin e përbashkët për president, por vetëm një ditë më vonë, gjashtë deputetë të LDK-së dolën kundër. Kreu i LDK-së tha se me këtë vendim, pashmangshëm këta deputetë po e çojnë vendin në zgjedhje, ndërsa Kurti më vonë e vlerësoi si "absurde", "të dëmshme" dhe "të papërgjegjshme" sjelljen e tyre, duke shtuar se ata dëshirojnë zgjedhje të reja. Emini thotë se paralajmërimi i Kurtit se do të takohet sërish me Abdixhikun dhe me kryesinë e LV-së për marrëveshjen nuk nënkupton se ai domosdoshmërisht po planifikon zgjedhje, por është një "strategji që i jep atij kohë dhe hapësirë politike". "Ai mund të vazhdojë të negociojë me LDK-në, të presë nëse gjashtë deputetët ndryshojnë qëndrim, të shohë nëse Aleanca mund të jetë më fleksibile dhe, mbi të gjitha, të presë edhe zhvillimet në Hagë më 16 shtator", thotë ajo, duke iu referuar shpalljes së aktgjykimit për rastin ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të akuzuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ndonëse thotë se jo domosdo Kurti po planifikon zgjedhje të reja, nëse nuk arrihet që

Aleanca apo PDK-ja të futen në marrëveshje për president, atëherë "koha e fituar mund të funksionojë edhe në favor të një skenari zgjedhor". "Dhe, këtu kalendari bëhet politikisht i rëndësishëm. Dështimi për të zgjedhur presidentin do ta shtynte vendin drejt një tjetër procesi zgjedhor në një kohë që mund t'i përshtatet Kurtit shumë më tepër sesa kundërshtarëve të tij", shprehet ajo. Sa i përket Aleancës, Emini thotë se ka hapësirë për fleksibilitet, pas paraqitjes së kushteve në këmbim të votës. Por, sipas saj, shtatë votat e partisë që drejtohej nga Ramush Haradinaj "nuk mund të merren automatikisht". PDK-ja e Hamzës, sipas saj, është në pozicion më kalkulues. Kjo parti, vlerëson Emini, nuk është e interesuar për zgjedhje, por është më e interesuar se çfarë do të ndodhë pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë. Sipas saj, një vendim lirues për ish-presidentin Hashim Thaçi, njëherësh ish-drejtnes i PDK-së, do t'i hapte rrugë rrikthimit potencial të tij në politikë, dhe rrjedhimisht do të ndryshonte ndjeshëm dinamikën brenda kësaj partie dhe skenës politike në përgjithësi. Emri i Thaçit është propozuar për president nga ish-kreu i

Aleancës, Haradinaj. Ndonëse ka pasur përkrahje për këtë kandidaturë nga Arian Tahiri i PDK-së, sekretarja e përgjithshme e partisë, Vlora Çitaku, ka thënë se Thaçi nuk ka nevojë për poste, por "për liri". E, pikërisht për shkak të zhvillimeve në Hagë, në këtë moment, sipas Eminin, për PDK-në do të ishte shumë e vështirë që të angazhohej në një marrëveshje të re politike me Kurtin. "Pas vendimit, në varësi të asaj se çfarë ndodh dhe si ndikon kjo në PDK, mund të kemi një situatë krejtësisht tjetër dhe një diskutim tjetër politik", vlerëson ajo. Megjithatë, duke folur për mundësinë e gjetjes së rrugëdaljes, ajo vë theksin tek afatet kohore. "Afatet për zgjedhjen e presidentit janë shumë të ngushta dhe zgjerimi i një koalicioni, negociimi me një partner të ri dhe gjetja e një formule që mund të pranohet nga të gjithë nuk është diçka që mund të bëhet lehtë në pak ditë", shprehet ajo. Rrjedhja e afatit 60-ditor për presidentin nis me konstituimin e Kuvendit - proces që nisi më 6 gusht, por nuk është përmbyllur pasi LV-ja insiston që fillimisht të ketë pajtim për presidentin. Por, Emini vlerëson se Kurti e

SCHUEBEL MERR DETYRËN SHEF I ZYRËS SË BE-së NË KOSOVË: INSTITUCIONET TË FORMOHEN SHPEJT

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Zyra e BE-së në Prishtinë ka njoftuar se Dirk Schuebel ka marrë detyrën ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, duke shërbyer shef i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe përfaqësues special i BE-së (EUSR).

Schuebel ka bërë thirrje për formimin e shpejtë të institucioneve, gjë që, sipas tij, do t'i mundësonte Bashkimit Evropian të angazhohej plotësisht me Kosovën dhe ta ofronte asistencën që ka në dispozicion për vendin. "Përpara nesh është një dritare e rëndësishme mundësie. Në të mirë të të gjithë qytetarëve të saj,

Kosovës i duhen institucione funksionale, të afta për të zbatuar reformat e nevojshme dhe për të shfrytëzuar plotësisht Planin e Rritjes së BE-së dhe fondet e konsiderueshme të IPA-s që priten së shpejti. Shfrytëzimi maksimal i këtyre mundësive kërkon përgjegjësi politike, institucione efektive dhe një fokus të qartë në reformat dhe agjendën e integritetit evropian", ka deklaruar ai.

Ai ka thënë se mezi pret të punojë me institucionet e Kosovës, aktorët politikë, shoqërinë civile, mediet dhe të gjitha komunitetet për ta

ndihmuar Kosovën në ecjen drejt integritetit. "Mezi pres të punoj me institucionet e Kosovës, aktorët politikë, shoqërinë civile, mediat dhe të gjitha komunitetet, për ta ndihmuar një Kosovë multietnike që të përparojë në rrugën e saj drejt integritetit në BE, në baza të barabarta me të gjithë partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor". "Do ta mbështes të ardhmen evropiane të Kosovës. Puna drejt këtij qëllimi kërkon përpjekje nga e gjithë shoqëria dhe një përkushtim të përbashkët për ta bërë integritetin në BE prioritet përtej ndarjeve politike.

Gjithashtu, do ta mbështes angazhimin konstruktiv të Kosovës në Dialogun e lehtësuar nga BE-ja mes Beogradit dhe Prishtinës, si dhe përparimin drejt normalizimit të marrëdhënieve, në bashkëpunim të ngushtë me Përfaqësuesin Special të BE-së për Dialogun, Peter Sorensen", ka thënë Schuebel.

Schuebel ka theksuar se Bashkimi Evropian do të vazhdojë të qëndrojë krah për krah me Kosovën, duke u mbështetur në më shumë se 25 vjet përkrahjeje që nga viti 1999, si partneri më i fuqishëm dhe më i besueshëm i Kosovës dhe

ofruesi më i madh i asistencës financiare. "BE-ja i ka ofruar Kosovës më shumë se 3.7 miliardë euro ndihmë, duke filluar nga rindërtimi, ndërtimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit, deri te zhvillimi ekonomik dhe mundësitë për të rinjtë. Së bashku, ne mund t'i shndërrojmë aspiratat evropiane të Kosovës në përparim konkret për të gjithë qytetarët e saj", ka thënë Schuebel.

Në ushtrimin e detyrave të tij, ambasadori Schuebel do të mbështetet nga zëvendëshefi i sapoemëruar i BE-së në Kosovë, Alexis Hupin, si dhe nga ekipi i Bashkimit Evropian në Kosovë.



menaxhoi politikisht mirë situatën pas zhvillimeve në LDK, që vetë kreu i LV-së i vlerësoi si negative.

Sipas saj, ai po ndërton narrativën ku paraqitet si lider i gatshëm për kompromis, "që vazhdon të kërkojë dialog me LDK-në dhe që është i gatshëm të presë deri në fund për ta gjetur një zgjidhje".

Në deklarinë në orët e vona të 1 shtatorit, Kurti insistoi se kandidati për president për LV-në vazhdon të jetë Bekim Sejdiu - ish-gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe ish-diplomat. Sipas Eminit, Kurti po bën "një lëvizje shumë strategjike" duke ngulur këmbë se "Bekim Sejdiu është 'kandidat i Republikës' dhe jo thjesht kandidat i një marrëveshjeje partiake". "Në këtë mënyrë, ai e ngre kandidaturën mbi

marrëveshjen LV - LDK dhe e paraqet mbështetjen e tij si çështje të interesit institucional. Në mënyrë indirekte, kjo është edhe një kritikë ndaj mënyrës se si po sillet LDK-ja: nëse kandidati është i Republikës dhe nëse qëllimi është zhblllokimi i institucioneve, atëherë ata që e kundërshtojnë mund të paraqiten si ata që po e pengojnë këtë interes", vlerëson ajo.

Pse Abdixhiku dhe Kurti po fajësojnë gjashtë deputetët?

Megjithatë, një gjë e përbashkët e Kurtit dhe Abdixhikut pas zhvillimeve më 1 gusht është fajësimi i gjashtë deputetëve të zgjedhur të LDK-së që kundërshtuan marrëveshjen

për president: Avdullah Hoti, Hykmete Bajrami, Kujtim Shala, Arben Gashi, Armend Zemaj dhe Janina Ymeri.

Të gjithë janë arsyetuar se vota e tyre është kundër bashkëpunimit me LV-në dhe "zgjatjen e pushtetit" të Kurtit. Emini thotë se Kurti dhe Abdixhiku kanë arsye të ndryshme pse e zhvendosin fajin te ky grup deputetësh.

Kurti, sipas saj, fajëson këta deputetë për bllokadën, e jo udhëheqjen e LDK-së, sepse ajo "mund t'i duhet për marrëveshje në të ardhmen edhe nëse ka zgjedhje të jashtëzakonshme".

Abdixhiku, ndërkaq, e përdor fajësimin për një objektvitet tjetër politik, thotë ajo. Ai "mund të distancohet nga përgjegjësia për rezultatin e ardhshëm të LDK-së", vlerëson Emini. "Nëse

partia e tij dështon, ai tashmë ka krijuar një narrativë ku fajin e mbajnë ata gjashtë deputetë që bllokuan marrëveshjen, ndërsa përgjegjësia politike për performancën e partisë zhvendoset tek ata. Në këtë kuptim, gjashtë deputetët mund të bëhen edhe një lloj 'scapegoat' [v.j. dash kurban] për problemet më të gjera të LDK-së", vlerëson ajo.

Megjithatë, kundërshtimet brenda LDK-së, sipas Eminit, kanë të bëjnë me atë se procesi i negociatave për marrëveshjen nuk ishte transparent. Ajo thotë se ky rezultat ishte i pritshëm, pasi brenda partisë së Abdixhikut prej kohësh ka ndarje e rivalitete "që shkojnë përtej kësaj kandidature".

Abdixhiku u sfidua nga një mocion mosbesimi në korrik, por i mbijetoi atij, duke

vazhduar në krye të partisë. Edhe më herët, ai kishte kërkuar votëbesim për të udhëhequr partinë, pas rezultatit zgjedhor. "Abdixhiku, si lider i partisë, mban përgjegjësinë kryesore për faktin që nuk ka arritur ta mbajë të bashkuar grupin e tij parlamentar dhe ta menaxhojë këtë konflikt brenda partisë. Ajo që po shohim sot është, mbi të gjitha, një krizë e lidershit dhe e kohezionit të brendshëm të LDK-së, e cila tani po manifestohet përmes procesit presidencial", vlerëson Emini. Nëse skena politike e Kosovës dështon të zgjedhë një president të ri, qytetarët do t'iu drejtohenin sërish kutive të votimit - për zgjedhjet e katërta në më pak se dy vjet dhe të dytat për shkak të moskonsensusit për çështjen e presidentit.

IKD dhe Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë lidhin marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Universiteti "Haxhi Zeka" (UHZ) në Pejë kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me qëllim të formalizimit dhe avancimit të bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e drejtësisë, edukimit juridik dhe kërkimit shkencor. Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua nga Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i IKD-së, dhe prof. dr. Armand Krasniqi,

rektor i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë. Para nënshkrimit të marrëveshjes palët zhvilluan një takim diskutimi, ku nga IKD morën pjesë Betim Musliu, zëvendësdrejtor ekzekutiv, dhe Arrita Reznici, menaxhere e programeve, ndërsa nga Universiteti "Haxhi Zeka" morën pjesë prof. assoc. Alma Shehu Lokaj, prorektore për Mësimdhënie, dr. sc. prof. assoc. Petrit Nimani, dekan i Fakultetit Juridik dhe prof.

assoc. Anita Cucović nga Qendra për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut e UHZ-së. Ky bashkëpunim synon krijimin e një partneriteti të qëndrueshëm ndërmjet IKD-së dhe UHZ-së përmes lidhjes më të ngushtë të edukimit universitar dhe kërkimit shkencor me analizën, monitorimin, ekspertizën dhe praktikën profesionale në fushën e drejtësisë. Përmes këtij bashkëpunimi synohet krijimi i mundësive të

reja për studentët, stafin akademik dhe hulumtuesit dhe kontributi në avancimin e sundimit të ligjit, qasjes në drejtësi, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, transparencës dhe llogaridhënies institucionale. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, IKD dhe Universiteti "Haxhi Zeka" riafirmojnë angazhimin e tyre për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve akademike dhe organizatave



profesionale, me fokus të veçantë në zhvillimin e juristëve të rinj dhe avancimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

LIMAJ: NË KOSOVË ME LEGJITIMITET JANË VETËM KRYETARËT DHE ASAMBLETË KOMUNALE, POSTET E TJERA PA LEGJITIMITET



PRISHTINË, 2 SHTATOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka ngritur pikëpyetje mbi legjitimitetin e institucioneve dhe posteve të tjera publike në Kosovë, duke vlerësuar se aktualisht legjitimitet të plotë politik kanë vetëm kryetarët e komunave dhe asambletë komunale. Sipas Limajt, këto institucione kanë dalë drejtpërdrejt nga vota e qytetarëve dhe, për rrjedhojë, janë të vetmet që gëzojnë legjitimitet të qartë nga procesi zgjedhor. "Me legjitimitet në Kosovë sot janë vetëm kryetarët

e komunave dhe asambletë komunale. Të gjitha postet e tjera janë pa legjitimitet", ka thënë Limaj për "IndeksOnline", duke iu referuar situatës aktuale institucionale në vend. Deklarata e kreut të Nismës vjen në një kohë kur debati politik në Kosovë është përqendruar te funksionimi i institucioneve, mandati i tyre dhe mënyra se si sigurohet legjitimiteti politik për organet qendrore. Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca po bëjnë thirrje të vazhdueshme për konstituimin

e Kuvendit, duke akuzuar Kurtin se po shkel Kushtetutën. Ndërsa kryeministri në detyrë, Albin Kurti dhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, kanë arritur pajtueshmëri për kandidaturën e Bekim Sejdiut për president, por ky propozim është refuzuar nga gjashtë deputetë të LDK-së. Seanca për konstituimin e Kuvendit është mbajtur më 6 gusht, por që është ndërprerë pasi kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka kërkuar kohë shtesë për diskutime mes partive.

RRITET PËR 83.3 % NUMRI I RASTEVE TË RAPORTUARA PËR TË SHTËNAT FESTIVE KRAHASUAR ME PERIUDHËN E VITIT TË KALUAR

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ministria e Punëve të Brendshme mbajti takim lidhur me zbatimin e fushatës "Festo me zemër, jo me armë" dhe shtimin e aktiviteteve në bashkësi me anëtarët e forumeve të sigurisë së qyteteve të rajonit të Prishtinës.

Sipas një njoftimi për medie, thuhet se zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Enver Dugolli, vuri në dukje se, në aspektin e parandalimit, përveç Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të gjitha agjencive të saj përkatëse, është e domosdoshme që edhe aktorët e tjerë institucionale, shoqëria civile, mediet dhe vetë qytetarët, ta marrin rolin e tyre aktiv në procesin e vetëdijesimit dhe sensibilizimit të shoqërisë. "Vetëm përmes një qasjeje të përbashkët dhe të koordinuar

mund t'i parandalojmë pasojat serioze që mund të vijnë nga posedimi i paligjshëm i armëve dhe veprimet e tjera kundërligjore, duke kontribuar kështu në rritjen e sigurisë dhe mirëqenies së përbashkët", theksoi zëvendësministri Dugolli.

Zëvendësministri Dugolli vuri në pah se misioni dhe angazhimi i përditshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe agjencive të saj është ndërtuar mbi parimin e bashkëpunimit të ngushtë me qytetarët, me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të nivelit të sigurisë në Republikën e Kosovës. Nëpërmjet këtij partneriteti synojmë jo vetëm garantimin e rendit dhe sigurisë publike, por edhe përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët tanë.

Në fund, zëvendësministri Dugolli theksoi se, në muajt në vijim, por edhe vitin e ardhshëm, do të bëjmë një fushatë intensive për t'i bindur të gjithë qytetarët pa dallim, si dhe bashkatdhetarët tanë të cilët kalojnë pushimet në Kosovë, se përdorimi i armës në festa dhe ahengje familjare është një veprim i kundërligjshëm dhe me pasojë deri tek ato fatale për qytetarët. Ai tha se në fokus do të jenë edhe shkollat, përkatësisht mbajtja e aktiviteteve të ndryshme, sepse përfaqësojnë një komunitet shumë të ndjeshëm të shoqërisë sonë. Në këtë takim, lidhur me ecurinë e fushatës dhe aktivitetet që do të ndërmerren vitin tjetër, kanë paraqitur pikëpamjet e tyre zyrtarë nga UNDP-ja, Policia e Kosovës,



anëtarë të KKS-së si dhe të KLSP-ve.

Në këtë takim u konstatua se, si rezultat i fushatës ndërgjegjësuere që është mbajtur gjatë këtyre viteve, në vazhdimësi kemi rritje të numrit të rasteve të raportuara nga ana e qytetarëve për të shtëna me armë.

Sipas të dhënave zyrtare nga Policia e Kosovës, gjatë muajve qershor-korrik 2026 ka rritje: për 83.3 % të raportimeve për përdorim të armëve gjatë ahengjeve/festave familjare; për 41.2 % të personave të ndaluar nga policia; për 56.7 % të numrit të armëve të konfiskuara.

Nga 50 deri në 300 euro për operacione, aktakuzë ndaj dy mjekëve në Vushtri dhe nëntë personave të tjerë

MITROVICË, 2 SHTATOR - Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, ndaj të pandehurve V. R. dhe E. S., për shkak të veprës penale "Marrja e ryshfetit", ndërsa ndaj të pandehurve F. V., B. Q., F. Xh., B. G., B. A., K. H., S. N., V. Y., L. K.

është ngritur aktakuzë për kryerjen e veprës penale "Dhënia e ryshfetit". Sipas kërkesës së prokurorisë, mjeku V. R., në gjashtë raste, ndërsa mjeku E. S., në tri raste, në cilësinë e personit zyrtar - mjekë në Spitalin e Vushtrisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkojnë dhe pranojnë para në shuma të ndryshme në mënyrë

që të veprojnë në përputhje me detyrën e tij zyrtare për ofrimin e shërbimeve të trajtimit mjekësor për pacientët. Ndërsa, nëntë të pandehurit F. V., B. Q., F. Xh., B. G., B. A., K. H., S. N., V. Y. dhe L. K. akuzohen se, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për vete apo për persona të tjerë, u kanë premtuar, ofruar ose dhënë

mjekëve të akuzuar shuma të ndryshme parash, nga 50 deri në 300 euro, si shpërblim për operimin e familjarëve të tyre. Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me rastin e ngritjes së aktakuzës, ka kërkuar nga gjykata të pandehurit t'i shpallë fajtorë për veprat e kryera penale dhe t'i dënojë sipas ligjit.



Presidentja Haxhiu pranoi letrat kredenciale të ambasadores së re të Zvicrës në Kosovë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ushtruesja e detyrës e presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, pranoi letrat kredenciale të ambasadores së re të Konfederatës Zvicerane në Republikën e Kosovës, Anne-Lise Cattin Hennin.

U. d. presidentja Haxhiu i uroi ambasadores Cattin Hennin mirëseardhje në Kosovë dhe sukses në misionin e saj diplomatik, duke shprehur bindjen se gjatë mandatit të saj marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës do të forcohen edhe më tej. “Kosova e çmon thellë miqësinë dhe mbështetjen e Zvicrës, e cila ka qenë pranë qytetarëve tanë në kohët më të

vështira dhe vazhdon edhe sot përmes bashkëpunimit politik, ekonomik, zhvillimor dhe të sigurisë”, tha Haxhiu. Ajo theksoi edhe rolin e rëndësishëm të mërgatës së Kosovës në Zvicër në afrimin e dy vendeve. “Një vend të veçantë në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës e ka

mërgata jonë atje, e cila ka dhënë kontribut të çmuar në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore të të dyja vendeve”, u shpreh Haxhiu. U. d. presidentja Haxhiu e siguroi ambasadoren Cattin Hennin për bashkëpunimin e saj të plotë në avancimin e mëtejshëm të partneritetit



ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane.

‘NËSE REPUBLIKA MË THËRRET, JAM GATI’, BISLIMI THYEN HESHTJEN: NËSE ELITAT POLITIKE NUK MË KONSIDEROJNË, FJALËN DO TA KETË POPULLI

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Faton Bislimi, kandidat i propozuar për president nga ish-ambasadori William Walker dhe ish-kongresisti Joe DioGuardi, ka reaguar pas zhvillimeve të fundit rreth propozimit që emri i tij të konsiderohet për president të Republikës së Kosovës.

Në një deklaratë publike, Bislimi ka falënderuar të gjithë ata që, sipas tij, e kanë përkrahur kandidaturën e tij, përfshirë figura të njohura amerikane dhe familjet e heronjve të Kosovës. “Kam marrë mbështetje të jashtëzakonshme nga njerëz që dashurinë për Kosovën e kanë dëshmuar me jetë e me vepra; nga miq të dëshmuar të Kosovës në Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, përfshirë ambasadorin William Walker dhe ish-kongresmenin Joe DioGuardi; nga familjet e heronjve Sali Çekaj dhe Agim Ramadani; nga shqiptarët e Luginës së Preshevës; nga miq e kolegë të mi nga Harvard Kennedy School; dhe, mbi të gjitha, nga qytetarë e atdhedashës të shumtë të Kosovës, nga çdo kënd i vendit dhe nga diaspora jonë. I jam nga zemra mirënjohës çdo vatre shqiptare, për çdo përkrahje, për çdo fjalë të mirë dhe për çdo shtrëngim dore që kam marrë këto ditë në mbështetje të propozimit që emri im të konsiderohet për President të Republikës së Kosovës”, ka shkruar Bislimi.



Bislimi ka theksuar se kandidatura e tij është një ofertë për t'i shërbyer Kosovës në një moment kur vendit, sipas tij, i nevojiten unitet, seriozitet institucional dhe

besim në të ardhmen. “Kandidatura ime nuk është kërkesë drejtuar një partie dhe nuk është ndërtuar kundër asnjë partie apo individi. Ajo ka qenë një ofertë për t'i shërbyer Republikës së Kosovës në një moment kur vendit i duhet unitet, seriozitet institucional dhe besim në të ardhmen. Dhe ajo ofertë qëndron! Nuk tërhiqem nga asnjë përgjegjësi që e kam marrë si amanet të brezave e si mision për të ardhmen e shtetit”, ka thënë ai.

Duke folur për mundësinë që elitat politike të mos e marrin në konsideratë kandidaturën e tij, Bislimi ka lënë të hapur mundësinë që çështja të marrë një rrjedhë tjetër. “Nëse elitat politike nuk e konsiderojnë

atë, atëherë fjalën do ta ketë populli”, ka deklaruar ai, duke shtuar se është i gatshëm të vazhdojë angazhimin publik dhe t'i shërbejë Republikës së Kosovës. “Detyra ime ndaj Kosovës vazhdon. Besimi im në atë që mund të bëhet Kosova vazhdon. Dhe gatishmëria ime për t'i shërbyer Republikës me tërë dijen, përvojën dhe forcën time mbetet e plotë dhe e palëkundur. Sepse në fund të fundit, pyetja nuk është dhe nuk duhet të jetë vetëm se kush e merr një pozitë. Pyetja më e rëndësishme është: Çfarë është më e mira për Kosovën? Përgjigja ime ka qenë e njëjtë për më shumë se dy dekada: Kosova e Para!”, ka shkruar Bislimi.

SVEÇLA SHPALLET FAJTOR PËR HEDHJE TË GAZIT LOTSJELLËS NË KUVEND

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, është shpallur fajtor për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvend më 21 mars 2018, në ditën kur ishte ratifikuar marrëveshja e demarkimit të kufirit me Malin e Zi.

Gjykatësi i rastit në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Sabit Sadikaj, tha se vendimi për veprën penale “përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” do të shpallet më 8 shtator, raporton “Betimi për Drejtësi”.

Në seancën e 8 shtatorit palët do t'i paraqesin rrethanat lehtësuese dhe rënduese për këtë rast.

Më 10 prill para gjykatës Sveçla ishte deklaruar i pafajshëm, ndërkaq në seancën e 2

shtatorit ai nuk ishte i pranishëm në gjykatë.

Njoftimi për shpalljen fajtor të Sveçlës vjen disa ditë pasi Gjykata Themelore në Prishtinë e liroi nga akuzat për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvend ministrin në detyrë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca.

Sipas aktakuzës së ndryshuar, Sveçla akuzohet se më 21 mars, në sallën plenare të Kuvendit, gjatë një seance të jashtëzakonshme ka përdorur gaz lotsjellës. Sipas Prokurorisë, ai e ka aktivizuar bombolën me gaz dhe e ka hedhur brenda sallës disa herë pa paralajmërim, duke mos u dhënë personave të pranishëm mundësi për t'u larguar.

Prokuroria ka hequr dorë nga ndjekja penale për veprën



“Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” për shkak të parashkrimit të kësaj vepre.

Bashkë me Sveçlën akuzohen edhe ministrja në detyrë e

Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Fitore Pacolli-Dalipi, ish-deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Salih Zyba dhe ish-deputetja e po kësaj

lëvizjeje, Drita Millaku.

Gazi lotsjellës është përdorur nga deputetët e Kuvendit të Kosovës për të kundërshtuar një sërë zhvillimesh politike.

Më 2015 deputetët e LV-së, që kundërshtonin marrëveshjen për normalizimin e raporteve me Serbinë, hodhën gaz lotsjellës në sallën plenare. Më pas, edhe ata të Aleancës dhe Nismës Socialdemokrate iu bashkuan kundërshtimit për marrëveshjen për demarkimin e kufirit me Malin e Zi, duke hedhur gaz në ambientet e Kuvendit.

Tre vjet më vonë, kur kjo marrëveshje u votua, në Kuvend sërish u hodh gaz lotsjellës dhe pati tensione dhe protesta brenda dhe jashtë ambienteve të organit ligjvënës.

Matura Shtetërore 2026: 55.1 % e kandidatëve e kalojnë afatin e dytë

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka njoftuar se, pas përfundimit të procesit të administrimit, vlerësimit dhe përpunimit të të dhënave, janë publikuar rezultatet e afatit të dytë të Provimit të Maturës Shtetërore 2026.

Në afatin e dytë provimit i janë nënshtruar gjithsej 4 433 kandidatë, prej të cilëve 2 444 e kanë kaluar me sukses testin, që përbën 55.1 për qind të numrit të përgjithshëm të kandidatëve. Arritshmëria mesatare e përgjithshme në test është 43.2

pikë, ndërsa sipas lëndëve është: Gjuhë amtare: 49.3 pikë; Gjuhë angleze: 44.1 pikë; Matematikë: 36.4 pikë; Lënda zgjedhore: 42.9 pikë.

Gjatë administrimit të testit, 18 kandidatë janë larguar nga provimi për shkak të mosrespektimit të rregullave

dhe procedurave të përcaktuara për administrimin e Provimit të Maturës Shtetërore.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës falënderon të gjithë personat e angazhuar në organizimin dhe administrimin e Provimit të



Maturës Shtetërore për kontributin në mbarëvajtjen e procesit.

AUDITORJA E PËRGJITHSHME: FORCIMI I LLOGARIDHËNIES DHE RRIJTJA E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE DUHET TË JENË PRIORITET I INSTITUCIONEVE PUBLIKE

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar Raportin Vjetor të Auditimit (RVA) për vitin 2025, i cili përmbledh rezultatet e 131 auditimeve të realizuara gjatë sezonit auditues 2025/2026 dhe paraqet çështjet kryesore të identifikuar në menaxhimin e financave publike, pajtueshmërinë dhe performancën e institucioneve publike. Raporti, gjithashtu, përmban rezultatet dhe opinionin e auditimit të "Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës" për vitin 2025. Në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor Raporti është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) për Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin

2025 ka dhënë opinionin të kualifikuar. Çështjet kryesore të identifikuar në auditimet individuale të organizatave buxhetore të cilat janë reflektuar në Pasqyrat e Buxhetit të Shtetit dhe kanë ndikuar në kualifikimin e opinionit të auditimit janë: klasifikimi joadekuat i shpenzimeve në vlerë prej 77 milionë eurosh, mbivlerësimi i pasurive në vlerë mbi 33 milionë euro, mbivlerësim i detyrimeve kontingjente mbi 29 milionë euro, nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme mbi katër milionë euro si dhe mbivlerësimi i detyrimeve të papaguara mbi dy milionë euro. Lidhur me mangësitë e identifikuar nga 131 auditime ZKA ka dhënë 1 032 rekomandime, prej të cilave 412 për nivelin lokal, 230 për nivelin qendror, 182 për ndërmarrjet



publike, 169 për auditimet e performancës si dhe 39 për auditimet e pajtueshmërisë. Fushat me numrin më të madh të rekomandimeve lidhen me pasuritë, investimet kapitale, mallrat dhe shërbimet, llogaritë e arkëtueshme, të hyrat dhe pagat. Auditorja e përgjithshme, Vlorë Spanca, vlerësoi se forcimi i llogaridhënies dhe rritja e

zbatimit të rekomandimeve duhet të jenë ndër prioritetet e institucioneve publike. Ajo u bëri thirrje drejtuesve të institucioneve publike që të ndërmarrin masa konkrete dhe në kohë për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit si dhe trajtimin e rasteve me dyshime potenciale për mashtrim. "Auditimi mund të identifikojë problemet dhe të

tregojë se çfarë duhet përmirësuar, por ndryshimi real varet nga veprimet që ndërmerren pas auditimit. Inkurajoj Kuvendin e Republikës së Kosovës që rezultatet e auditimeve t'i përdorë në mënyrë më aktive për të forcuar mbikëqyrjen dhe llogaridhënien e institucioneve", ka deklaruar Spanca. RVA për vitin 2025 vë në pah se krahas përparimit të shënuar në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar, prezantimin e të dhënave dhe forcimin e kontroleve të brendshme, niveli i zbatimit të rekomandimeve mbetet i pamjaftueshëm dhe kërkon angazhim të mëtjetshëm nga institucionet publike. Nga 766 rekomandime të vlerësuara nga viti 2024, 274 apo 36 % ishin zbatuar, 61 apo 8 % ishin zbatuar pjesërisht, ndërsa 431 apo 56 % nuk ishin zbatuar.

EDHE 21 TË DYSHUAR PËR KEQPËRDORIME NË BKS

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Autoritetet njoftuan se kanë zgjeruar hetimet për rastin e dyshimeve për keqpërdorime në Byronë Kosovare të Sigurimeve (BKS) dhe tani nën hetim janë edhe 21 persona të tjerë. Prokuroria Themelore në Prizren tha se 21 personat dyshohet se kanë kryer veprën penale të "keqpërdorimit të besimit në besim", duke bërë që numri i përgjithshëm i të përfshirëve në këtë rast, që u iniciua në janar të këtij viti, të arrijë në 69 të pandehur. Të 21 të pandehurit dyshohet

se duke mos respektuar rregullat dhe procedurat e BKS-së, kanë mundur ose kanë marrë pjesë në bartjen dhe në përfundimin e shumave të të hollave pa mbulesë, në vlerë nga 2 000 deri në 53 000 euro për person, tha Prokuroria Themelore në Prizren. Dëmi shtesë i shkaktuar, sipas organit hetues, është rreth 200 000 euro. Paraprakisht, autoritetet kishin vlerësuar se dëmi i shkaktuar nga keqpërdorimet e dyshuara në BKS të jetë rreth 1 043 000 euro. Në aksionin e 1 shtatorit,



autoritetet kanë sekuestruar dhe kanë ngrirë 35 prona, përfshirë parcela kadastrale, njësi banesore dhe njësi garazhuese, "të cilat ndërlidhen me tre të pandehurit kryesorë, ndaj të cilëve ekziston dyshimi për përfshirje në veprimet

kriminale që kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm financiar ndaj Byrosë Kosovare të Sigurimeve". "Gjithashtu, gjatë ditës së sotme Prokuroria në bashkëpunim me Njësitin e Inteligjencës Financiar, ka urdhëruar ngrirjen e 21 llogarive bankare të personave të dyshuar", tha Prokuroria. Në janar, lidhur me dyshimet për keqpërdorime në BKS, autoritetet arrestuan dhjetëra persona, përfshirë edhe ish-drejtorin ekzekutiv Sami Mazreku dhe ish-drejtorin e financave në këtë byro, Valon Berisha.

Pas arrestimit të tyre prokuroria tha se Mazreku dhe Berisha dyshohet se, duke keqpërdorur autorizimet e BKS-së, kanë mundur të kryerjen e transaksioneve të paligjshme. Byroja Kosovare e Sigurimit është organizatë jofitimprurëse, e cila është përgjegjëse për administrimin e sigurimit të detyrueshëm të automjeteve në Kosovë dhe mbikëqyrjet nga Banka Qendrore e Kosovës. Ajo u themelua më 7 gusht 2011, bazuar në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

RRITET NUMRI I NDËRMARRJEVE TË REGJISTRUARA

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Repertorin Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë për muajin korrik 2026. Në korrik 2026 krahasuar me muajin paraprak, ka rritje për 45 % të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërsa krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, ka rritje për 20,4 % të ndërmarrjeve të regjistruara.

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas sektorëve

Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij muaji ishin: tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 356 (22,5 %), prodhim me 166 (10,5 %), ndërtimtari me 159 (10,0 %), akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 147 (9,3 %), etj.



Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas kategorisë

Në kategorinë "Mikro Ndërmarrje" (0 deri në 9 të

punësuar) janë gjithsej 1 563 ndërmarrje të regjistruara, në kategorinë "Ndërmarrje të Vogla" (10 deri 49 të punësuar) janë gjithsej 18 ndërmarrje të regjistruara, në kategorinë "Ndërmarrje të Mesme" (50 deri 249 të punësuar) janë gjithsej 2 ndërmarrje. Kurse në kategorinë "Ndërmarrje të Mëdha" (250+), nuk kemi ndërmarrje të regjistruara këtë muaj

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas shtrirjes gjeografike

Shtrirja gjeografike e ndërmarrjeve të regjistruara në nivel rajoni është: Rajoni i Prishtinës prinë me 738 ndërmarrje të regjistruara (46,6 %), Rajoni i Prizrenit me 169 (10,7 %), Rajoni i Ferizajt me 156 (9,9 %), Rajoni i Pejës me 152 (9,6 %), Rajoni i Mitrovicës me 130 (8,2 %), Rajoni i Gjiçanit me 122 (7,7 %), dhe Rajoni i Gjakovës me 116 (7,3 %).

OEK-u dhe WOBA do të bashkëpunojnë për rritjen e përfaqësimit të grave në bordet drejtuese

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Oda Ekonomike e Kosovës dhe Women on Boards Adria (WOBA) do të bashkëpunojnë për rritjen e përfaqësimit të grave në bordet drejtuese dhe avancimin e qeverisjes korporative në Kosovë. Kryetari i OEK-ut, Lulzim Rafuna, u takua me ambasadorin

rajonale të WOBA-s, Tanja Mihajlovska Dimitrievska, dhe ambasadorin e WOBA-s dhe drejtoreshë menaxhuese e EOS në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë, Katerina Boshevska. Gjatë takimit u diskutua për programet e WOBA-s në Kosovë, përgatitjen e grave për pozita drejtuese, përfshirjen e

profesionistëve të Kosovës në rrjetin rajonal dhe bashkëpunimin me kompanitë e institucionet. "Kjo nuk është vetëm një fushatë ndërgjegjësimi, por punë konkrete për qeverisjen korporative - përgatitjen e kandidateve, profesionalizimin e përzgjedhjes dhe krijimin e mundësive për gratë e

kualifikuara. OEK-u dëshiron që bizneset e Kosovës të jenë pjesë e këtij procesi dhe të ndihmojnë në formësimin e kësaj reforme", tha Rafuna. OEK-u dhe WOBA do t'i koordinojnë hapat e ardhshëm për të sjellë në Kosovë programe për leadership dhe përgatitje për borde si dhe për ta fuqizuar



lidhjen e profesionistëve të Kosovës me rrjetin rajonal.

PO SIKUR QËLLIMI I PUTINIT TË MOS JETË TË FITOJË LUFTËN?



Pas më shumë se katër vjetësh luftime, Rusia ka paguar një çmim të jashtëzakonshëm dhe megjithatë Vladimir Putin nuk tërhiqet. Ndoshta ka ardhur momenti të ngrihet pyetja: Cili është qëllimi i Putinit? Dhe çfarë quan ai “fitore”?

Kur flasim për luftë, instinktivisht kërkojmë një fitues dhe një humbës. Shikojmë hartën. Numërojmë territoret e pushtuara dhe të rimarra. Shikojmë humbjet ushtarake, armët, ekonominë, sanksionet. Dhe pastaj përpigemi të kuptojmë se kush po fiton.

Por lufta në Ukrainë ngre një pyetje shumë më të vështirë: Po sikur Vladimir Putin të mos jetë duke e matur suksesin me të njëjtën metër që përdorim ne? Po sikur objektivi i tij të mos ketë qenë prej kohësh një fitore e shpejtë dhe spektakolare, por diçka shumë më e ngadaltë: të ndryshojë kushtet mbi të cilat do të ndërtohet paqja?

Kjo nuk do të thotë se gjithçka që ka ndodhur ishte pjesë e një plani të përsosur rus. Lufta ka prodhuar dështime, kosto dhe pasoja që Moska me shumë gjasë nuk i parashikoi në shkurt 2022. Por pas më shumë se katër vjetësh, mënyra se si Rusia vazhdon luftën na detyron të bëjmë një pyetje tjetër. Çfarë po përpigjet të arrijë Putin tani?

Një çmim kolosal. Por të gjithë e vazhdojnë luftën

Rusia ka paguar dhe vazhdon të paguajë shumë.

Lufta ka konsumuar njerëz, pajisje dhe burime financiare. Ekonomia ruse vazhdon të funksionojë nën një regjim të gjerë sanksionesh perëndimore dhe vetëm ditët e fundit Britania

ka shtuar masat kundër rrjeteve që ndihmojnë Moskën t'i shmangë ato. SHBA, nga ana tjetër, i ka bërë të qartë Moskës se lehtësimi ekonomik mbetet i lidhur me përfundimin e luftës. Edhe sektori rus i energjisë po ndien presionin. Parashikimet e fundit të siguruar nga Reuters tregojnë se prodhimi rus i naftës për vitin 2026 mund të bjerë në nivelin më të ulët që prej vitit 2009, mes pasojave të luftës, kufizimeve tregtare dhe goditjeve ukrainase ndaj infrastrukturës energjetike.

E megjithatë, Moska nuk po jep shenja se është gati të ndalet. Përkundrazi, luftimet vazhdojnë dhe forcat ruse po përpigjet të avancojnë më tej në Donbas. Po nëse kostoja është kaq e madhe, çfarë e bën Kremlinin të mendojë se ia vlen të vazhdojë?

Ndoshta po shohim tabelën e gabuar të rezultatit

Nëse luftën e shohim vetëm përmes kilometrave katrorë, përgjigja mbetet e paqartë. Por ekziston edhe një mënyrë tjetër për ta lexuar. Putini mund ta konsiderojë sukses jo vetëm territorin që kontrollon Rusia, por edhe kushtet politike dhe strategjike që lufta prodhon me kalimin e kohës.

Në këtë këndvështrim, shfaqen bëhen të tjera: Sa gjatë mund ta mbështesë Perëndimi Ukrainën? Sa e kushtueshme bëhet lufta për ekonominë dhe shoqërinë ukrainase? Sa territor mund të mbajë Rusia? Dhe mbi të gjitha: Si do të duket Ukraina kur të vijë momenti i negociatave?

Ky është një ndryshim thelbësor perspektive. Sepse atëherë objektivi nuk është

domosdoshmërisht pushtimi i gjithë Ukrainës. Objektivi mund të jetë krijimi i një realiteti të tillë që marrëveshja përfundimtare të jetë sa më afër interesave të Moskës.

Ukraina është njëkohësisht objektivi dhe leva

Për Rusinë, Ukraina nuk është vetëm territori ku zhvillohet lufta. Ajo është edhe pika përmes së cilës Moska përpigjet të ndikojë arkitekturën e sigurisë europiane. Kremlinin ka kërkuar vazhdimisht që Ukraina të mos anëtarësohet në NATO dhe ka kërkuar njohjen e kontrollit rus mbi territoret që Moska pretendon ose mban të pushtuara.

Kështu, çdo muaj që kalon nuk ndryshon vetëm vijën e frontit. Ai ndryshon edhe pozicionet nga të cilat palët do të negociojnë një ditë. Nëse Rusia arrin të mbajë territore, ndërsa Ukraina mbetet jashtë NATO-s dhe lufta vazhdon të konsumojë burime ukrainase e perëndimore, Kremlinin mund ta shohë kohën jo vetëm si kosto. Mund ta shohë edhe si levë.

Megjithatë, do të ishte gabim të interpretonim çdo dështim rus që prej vitit 2022 si pjesë të një strategjie brilante afatgjatë. Rusia u përpoq fillimisht të merrte Kievin dhe dështoi. Ukraina rimori territore të konsiderueshme. NATO, në vend që të dobësohej menjëherë, u zgjerua me Finlandën dhe Suedinë. Dhe lufta ka sjellë pikërisht atë që Moska pretendonte se donte të shmangte: një prani më të madhe të NATO-s pranë kufijve rus.

Prandaj teza se “Putin e kishte planifikuar kështu që në fillim”

nuk qëndron.

Por ekziston një mundësi tjetër, shumë më realiste: strategjia mund të ketë ndryshuar kur fitorja e shpejtë dështoi. Nga marrja e shpejtë e Ukrainës, drejt konsumimit të saj. Nga një fitore ushtarake absolute, drejt krijimit të një pozicioni negociues sa më të favorshëm.

Lufta e konsumimit

Kjo është pikërisht ajo që e bën konfliktin kaq të rrezikshëm. Sepse lufta nuk matet vetëm me territoret e fituara nga secila palë, por edhe shihet se kush lodhet I pari.

Ukraina po përballlet me presion të jashtëzakonshëm financiar dhe ushtarak. Qeveria ukrainase aktualisht përlllogarit një boshllëk prej rreth 27 miliardë dollarësh në buxhetin e mbrojtjes, ndërsa financimi ndërkombëtar mbetet jetik. Ndërkohë Rusia po intensifikon sulmet ajrore. Vetëm në korrik, OKB regjistroi 437 civilë të vrarë dhe 2,610 të plagosur në Ukrainë, niveli më i lartë muajor i viktimave civile që prej majit 2022.

Në fund të gushtit, goditjet ruse u përqendruan gjithashtu mbi infrastrukturën ekonomike dhe logjistike ukrainase, ndërsa sulmet e fundit kanë vazhduar edhe mbi Kievin dhe rajonin përreth.

Por edhe Ukraina po përpigjet ta bëjë luftën më të kushtueshme për Rusinë, duke goditur energjinë, logjistikën dhe objektiva ekonomikë thellë brenda territorit rus. Pra, kemi dy palë që po përpigjet gjithnjë e më shumë të dëmtojnë jo vetëm ushtrinë e kundërshtarit, por aftësinë e tij për ta vazhduar luftën.

Atëherë, çfarë mund të quante Putin “fitore”?

Jo domosdoshmërisht flamurin rus mbi Kiev. Një rezultat shumë më realist për Moskën mund të ishte një Ukrainë që mbetet jashtë NATO-s; një pjesë e territorit ukrainas që mbetet nën kontroll rus; kufizime ose garanci mbi konfigurimin e ardhshëm të sigurisë ukrainase; dhe një marrëveshje që e detyron Perëndimin të pranojë, të paktën de facto, një pjesë të realitetit territorial të krijuar nga lufta.

Në atë skenar, Rusia nuk do ta kishte “fituar” luftën në kuptimin klasik. Por Putin mund të pretendonte se kishte arritur objektivin strategjik. Dhe kjo është një diferencë e madhe. Lufta mund të fitohet edhe në tryezën e negociatave. Ndoshta kjo është mënyra më interesante për ta parë atë që po ndodh. Luftërat nuk përfundojnë gjithmonë kur një ushtri shkatërron tjetrën. Shpesh përfundojnë kur raporti i forcave në fushë krijon kushtet për një marrëveshje politike.

Në këtë kuptim, çdo qytet i marrë, çdo sistem armësh i humbur, çdo miliard i shpenzuar dhe çdo muaj që kalon mund të bëhet pjesë e negociatës së ardhshme.

Atëherë, çfarë paqeje po përpigjet të krijojë Putin përmes luftës? Sepse objektivi përfundimtar mund të mos jetë pushtimi i Ukrainës. Mund të jetë një Ukrainë aq e dobësuar dhe një Perëndim aq i lodhur, sa kushtet që në vitin 2022 dukeshin të papranueshme, një ditë të fillojnë të diskutohen si kompromis. Dhe këtu qëndron ndoshta beteja më e madhe. / bota.al

NJË REND I RI BOTËROR PO VJEN DHE NE NUK JEMI GATI

Nga Margaret MACMILLAN,
The New York Times

Ka gjithmonë shenja kur një stuhi është pranë. Erërat mund të shtohen papritur. Dallgët mund të shkojnë më larg se zakonisht. Një pafundësi resh lëvizin nëpër qiell.

Ndodh që t'i keqlexosh këto shenja ose edhe t'i injorosh plotësisht – të këmbëngulësh që pikat e shiut janë vetëm një rrebsh kalimtar – derisa vjen koha kur është tepër vonë. Atëherë nisin telashet e vërteta.

Ajo çka është e vërtetë për motin është gjithashtu e vërtetë edhe për marrëdhëniet njerëzore. Regjimet duken të forta deri sa nuk janë më të tilla. Revolucionet në shtëpi dhe trazirat në rendin ndërkombëtar – të dyja kombinohen kaq shpesh me njëra-tjetrën – janë të lehta për t'u parë në retrospektivë, por jo gjithmonë parashikohen. E megjithatë, nëse shohim më nga afër, shpesh zbulojmë se shenjat kanë qenë aty qysh në fillim.

Ne që jetojmë në shoqëri relativisht të qëndrueshme dhe me rregulla na pëlqen të besojmë, sikurse personazhi absurd i Volterit, Dr. Pangloss, i cili kalon nga një katastrofë në tjetrën, se “gjihtëcka ndodh për më mirë.” Mund të ankohemi për ekonominë apo mundësinë e një tjetër lufte të largët, ose të dëgjojmë duke aprovuar zërat radikalë nga secili krah i spektrit politik, por kursesi nuk na e merr mendja se bota jonë do të kthehet përmby.

Do të bënim mirë të dëgjonim paralajmërimin e një tjetër autori francez. Në romanin “Murtaja” të Alber Kamy, kur rrugët e qytetit algerian të Oranit pushtohen nga minj të ngordhur dhe njerëzit infektohen nga një sëmundje misterioze, qeveria lokale dhe shumica e popullsisë i injorojnë shenjat deri sa është tepër vonë. “Historia njeh po aq murtaja sa edhe luftëra,” thotë narratori i Kamy, “e megjithatë si murtajat ashtu edhe luftërat vazhdojnë t'i kapin në befasi njerëzit.”

Sot kemi “minj të ngordhur” ngado. Temperatura të reja rekord janë regjistruar këtë verë, toka është përballur me thatësia dhe zjarre shkatërrimtare. Borxhi në ekonominë e përparuarë të botës po arrin nivele historike. Shkurtimet e fondeve në ndihma ushqimore dhe mjekësore, kryesisht nga SHBA, kanë shkaktuar vdekje të panevojshme dhe kanë ndihmuar në përhapjen e sëmundjeve, njëra prej të cilave, herët a vonë, mund të kthehet në një tjetër pandemic. Inteligjenca artificiale vazhdon të zhvillohet shpejt dhe pa rregulla, duke kërcënuar vendet e punës, sigurinë dhe, në disa projeksione më të zymta, vetë ekzistencën njerëzore.

Fuqitë revizioniste i shpërfillin pa kurrfarë frike rregullat dhe normat. Elektoratet janë të zemëruar dhe të brishtë. Diplomacia e avashtë dhe diskrete, e cila ndërton besim dhe kuptim, ia ka lënë vendin një stili të pacipë performativ, i përshtatshëm vetëm për TikTok-un ose këndin e lojrave të fëmijëve.

Programi i të Dhënave të Konfliktëve në Uppsala regjistroi

vitin e kaluar 65 konflikte ndërshtetërore, shifra më e lartë që nga viti 1946. Fuqitë e mëdha gjenden të bllokuara në luftër asimetrike me shtete që po shfrytëzojnë në maksimum teknologjitë e reja. Lufta e Putinit në Ukrainë, që supozohej të fitohej brenda pak ditësh, po hyn në vitin e pestë. Irani, duke përdorur dronë të lirë të prodhuar në masë për të sulmuar forcat amerikane dhe aleate, ka marrë nën kontroll, ndoshta përgjithmonë, një korridor tregat kyç, duke reduktuar në mënyrë drastike rezervat e raketave të SHBA-së dhe duke e bllokuar Presidentin Trump në një luftë të cilën e zgjodhi vetë.

Një luftë botërore nuk është e pashmangshme, por kërcënimi nga një konflikt katastrofik mes fuqive të mëdha e të mirëarmatosura është më pranë seç ka qenë për dekada të tëra.

Sikurse banorët e Oranit të Kamysë, ne hezitojmë të pranojmë se sa shumë ka ndryshuar bota. Problemet janë serioze, komplekse dhe të lodhshme, kështu që është më e lehtë të kthesh kokën në anën tjetër. Ndaj shkojmë për pushime buzë detit, ndërsa zjarret vazhdojnë të djegin; pyesim AI-në si të trajnojmë qenin, si të shkruajmë një letër – të mendojë për ne. Shpresojmë që luftërat do të përfundojnë, që kornizat mbrojtëse, institucionet dhe aleancat do të rindërtohen dhe që bota siç e njohim do të rimëkëmbet dhe të lulëzojë.

Por një realitet i ri ia ka behur me shpejtësi të frikshme. Rendi botëror që na ka shoqëruar për pjesën më të madhe të jetës, nisi të gërryhej kur njerëzit që jetonin brenda tij u bënë më të nënshtruar e të bdinur dhe kur nisen të pranon – madje të aprovin – sjellje të këqija.

Kemi mbërritur në një epokë të re kaosi. Duhet të përgatitemi, çka nis me të qenët të singertë rreth seriozitetit të momentit në të cilin gjendemi dhe të pranojmë se sistemi ynë i brishtë po thyhet. Se vendet e tjera kanë nisur të përshtaten, për mirë ose për keq. Dhe se çdo e ardhme bashkëpunimi do duhet të jetë krejt ndryshe.

Po ç'ndodh me ata që nuk pranojnë të përshtaten dhe këmbëngulin se një sistem në rrënim e sipër mund të vazhdojë? Konsideroni tri revolucione që ishin të tilla dhe një që nuk ishte. Në prag të Revolucionit Francez, Franca, fuqia më e madhe tokësore e Europës, ishte me shumë gjasë një shtet i falimentuar, kryesisht për shkak të shumave të jashtëzakonshme që kishte marrë hua për të financuar luftën kundër britanikëve gjatë Revolucionit Amerikan. Elitat sunduese, ekstravagante dhe të korruptuara, e kishin humbur busullën, ndërsa një shtresë e mesme gjithnjë e më e fuqishme, por e përjashtuar nga pushteti politik, kërkonte ndryshim. Në fund të piramidës shoqërore, punëtorët dhe fshatarët përballeshin me urinë dhe dëshpërimi po rritej.

Ndërkohë po qarkullojnë ide të reja dhe të fuqishme të lluminizmit, disa prej tyre të importuara pikërisht nga Revolucionit Amerikan, për të drejtat e njeriut dhe forma të reja



qeverisjeje që do t'i jepnin pushtet të paktën një pjesë të popullit.

Mbretërit francezë dhe oborri i tyre nuk e kuptuan thellësinë e pakënaqësisë dhe menduan se asgjë nuk mund t'i lëkundte nga pozita e privilegjuar. Gabuan. Monarkia u përmby dhe në vend të saj lindi një republikë kaotike dhe e dhunshme. Brenda një dekade, Napoleon do të bëhej perandor.

Nuk ekziston një model i vetëm për ndryshimet revolucionare, por ata që ndodhen në majë të një regjimi shpesh nuk e kuptojnë sa i brishtë është sistemi mbi të cilin qëndrojnë. Revolucioni Rus i vitit 1917 erdhi si pasojë e disfatës jashtë vendit dhe jo e një fitoreje të kushtueshme. Por edhe Cari Nikolla II këmbëngulte, kundër çdo prove, se nuk kishte nevojë për reforma, sepse rusët vazhdonin ta adhuronin.

Në Gjermaninë e viteve 1930, Hitleri u fut në pushtet nga elitat që besonin, gabimisht, se do të mund ta përdornin dhe se sistemi ekzistues ishte mjaftueshëm i fortë për ta mbajtur nën kontroll. Secili prej këtyre revolucioneve pati pasoja të thella ndërkombëtare. Napoleon i çoi Francën drejt dominimit të kontinentit, duke shkatërruar institucione të vjetra dhe ide si e drejta hyjnore e mbretërve për të sunduar. Bolshëvikët, pasi morën pushtetin në Rusi, predikuan dhe nxitën internacionalizmin revolucionar, duke i shpallur luftë kapitalizmit dhe vendeve demokratike në të gjithë botën.

Hitleri e riarmatosi Gjermaninë, pushtoi pjesën më të madhe të Europës dhe vrau miliona hebrenj dhe shumë të tjerë në emër të dominimit arian.

Megjithatë, ka raste kur vendet dhe udhëheqësit e tyre arrijnë t'i lexojnë shenjat në kohë. Në vitet 1820, qeveria britanike po përballej me presionin e shtresës së mesme, të krijuar rishtazi nga Revolucionit Industrial, por ende të përjashtuar nga vendimmarrja politike. Elita britanike, me katastrofën franceze ende të freskët në kujtesë, e kuptoi se duhej të përshtatej nëse donte të mbijetonte. Akti i Madh i Reformës i vitit 1832 funksionoi si një valvul shkarkimi, duke zgjeruar mjaftueshëm të drejtën e votës për të shmangur një krizë më të gjerë.

Është e lehtë të gesh paralele me momentin tonë. Popullsia të zemëruara. Elita të pazgjedhura me pasuri të jashtëzakonshme dhe fuqi të mjaftueshme për t'i përkulur qeveritë sipas interesave të tyre. Udhëheqës që refuzojnë të ndërtojnë konsensus apo të dëgjojnë këshilla.

Kur në janar Donald Trump u pyet se çfarë kufijsh kishte

pushteti i tij, ai u përgjigj: “Moralim”. Luigi XIV e la Francën të dobësuar rëndë pas luftërave që zhvilloi, siç thoshte vetë, për “la gloire”, lavdinë e tij.

Ata që zgjedhin t'i shpërfillin shenjat paralajmëruese dhe ta hedhin poshtë historinë si të parëndësishme për të tashmen mund të befasohen, madje të tmerrohen, kur ngjarjet që nuk i dëshironin t'u ndodhin gjithsesi. Rendi ndërkombëtar ka qenë gjithmonë i varur nga mbështetja e fuqive të mëdha dhe nga bashkëpunimi e pranimi i një numri të mjaftueshëm fuqish më të vogla. Në fund të Luftës së Ftohtë, me zhdukjen e Bashkimit Sovjetik, Shtetet e Bashkuara dukeshin të gatshme të vazhdonin si garantuesja e sistemit të ngritur pas vitit 1945.

Nën Presidentin Trump, kjo nuk është më e sigurt.

Mund të ndodhë që, nën një president tjetër, Shtetet e Bashkuara të rikthehen në rolin e tyre si hegemonë, mbështetëse të gatshme të institucioneve dhe normave ndërkombëtare, aleate e mirë dhe e besueshme dhe kundërshtarë e vendosur e tiranëve. Atëherë bota mund të vazhdojë sërish, të paktën nga disa këndvështrime, po aq paqësish sa ka vazhduar që nga viti 1945.

Fuqitë e mëdha, tashmë përfshirë Kinën dhe Indinë, do të vazhdojnë të bashkëjetojnë me fërkime, por pa u përplasur drejtpërdrejt, ndërsa diçka që vazhdojmë ta quajmë “komuniteti ndërkombëtar” do t'i rikthehet punës për të luftuar varfërinë, padrejtësinë, konfliktet dhe ndryshimet klimatike.

Por po sikur tashmë të kemi hyrë në fazat e para të një periudhe të gjatë çrregullimi?

Një botë ku nuk mund të supozojmë më se ajo që ishte e vërtetë dje do të jetë e vërtetë edhe nesër, apo se institucionet që duken të pathyeshme do të vazhdojnë të ekzistojnë. Ndoshta duhet të mësojmë të mos habitemi më nga ajo që sjell çdo ditë lajmi.

Ndodhin katastrofa natyrore si përmbytjet në Nepal dhe Tibet dhe nuk është më e qartë se kush do të vijë në ndihmë. A ngremë supet dhe vazhdojmë jetën tonë?

Konflikte, disa prej të cilave mund të përfshijnë fuqitë e mëdha, shpërthejnë pa ndonjë arbitër të dukshëm. Aleanca që i kemi konsideruar të sigurta, si NATO, po vihen vazhdimisht në provë dhe mund edhe të shpërbëhen. Lufta hibride e Rusisë ndaj Europës po zgjerohet; Kina dhe Shtetet e Bashkuara mund të përplasen për Tajvanin; ndërsa konkurrenca për burime në një botë gjithnjë e më të nxehtë dhe më të thatë tashmë po ushqen dhunë.

Kjo është një botë gjithnjë e më e paparashikueshme, ku, shumë më tepër nga sa e kishim menduar, mbetemi në mëshirën e udhëheqësve tanë. Ata janë më pak të kufizuar nga kornizat e jashtme dhe ndihen më të lirë t'i shpiknin rregullat gjatë rrugës.

Pikërisht në këtë moment duhet t'i zgjedhim vendimmarrësit tanë me më shumë kujdes se kurrë, ndërkohë që elektoratet duken gjithnjë e më pak të prirura ta bëjnë këtë.

Retë janë të zeza. Por fundi i

sistemit të vjetër nuk do të thotë domosdoshmërisht fundi i bashkëpunimit.

Ne ende kemi shumë prej elementeve të një rendi botëror funksional. Ekziston një rrjet i pasur institucioneve ndërkombëtare, shumë prej të cilave pothuajse të padukshme në jetën e përditshme, që menaxhojnë lidhjet mes vendeve, nga aviacioni civil te interneti.

Traktatet në pjesën më të madhe vazhdojnë të respektohen. E drejta ndërkombëtare dhe sovraniteti mund të jenë të vështira për t'u imponuar dhe mbrojtur, por shumica prej nesh vazhdon t'i dënojë shkeljet e tyre. Vetë ekzistenca e një opinioni publik ndërkombëtar ende mund të ushtrojë presion mbi udhëheqësit.

Shumë prej organizatave të strukturës që po zbehet, mes tyre Kombet e Bashkuara, Organizata Botërore e Tregtisë dhe Banka Botërore, po humbasin gjithnjë e më shumë burime dhe kuptim. Por vazhdojnë të ekzistojnë.

Në një fjalim shumë të diskutuar në Davos në janar, kryeministri kanadez Mark Carney, disa muaj përpara se negociatat tregtare me Shtetet e Bashkuara të dështonin, e përshkroi fundin e Pax Americana-s si fundin e një “iluzioni të këndshëm”.

Por vendet e tjera mund të kundërveprojnë, tha ai, sidomos nëse bashkohen në koalicionë të ndërtuara mbi vlera dhe objektiva të përbashkëta. Një numër fuqish të mesme, përfshirë Kanadanë, Australinë dhe Japoninë, tashmë po përpiqen të punojnë së bashku për të mbushur boshllëkun që ka lënë tërheqja e Shteteve të Bashkuara nga roli i dikurshëm i superfuqisë dashamirëse.

Ndryshimi është i vështirë, por kapja pas mënyrave të vjetra mund të jetë një iluzion i rrezikshëm.

Në verën e vitit 1914, ministri i Jashtëm britanik, Sir Edward Grey, dhe shumë të tjerë në pozita pushteti në Britani dhe në Europë supozuan se kriza më e fundit në Ballkan do të zgjidhej, ashtu si krizat e mëparshme, përmes një konference të fuqive të mëdha.


Ai nuk arriti të kuptonte sa shpejt po rrëshqiste Europa drejt luftës dhe as ta përdorte peshën e madhe të Britanisë për t'i ulur palët në tryezë. Lufta e Parë Botërore e ndryshoi Europën dhe botën përgjithmonë.

Deri në vitin 1945, Britania, Bashkimi Sovjetik, Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre kishin luftuar dy luftëra botërore brutale brenda tri dekadash.

Kur ngritën arkitekturrën e rendit që kemi trashëguar, ata e dinin shumë mirë se çfarë donin të shmangnin. Kornizat e mëparshme kishin dështuar. Kësaj here do të ndërtonin diçka të re që nuk duhej të dështonte.

Ruga panglosiane e optimizmit të pabazë është një rrugë pa krye. Por kjo nuk do të thotë se nuk mund të bëjmë atë që njerëzit kanë bërë kaq shpesh më parë: të nisim punën e gjatë, të lodhshme dhe të vështirë për të ndërtuar diçka të re nga fillimi.

Margaret MacMillan është historiane dhe ish-drejtuese e 'St. Antony's College' në Universitetin e Oksfordit.



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

INAUGUROHET ZYRTARISHT 'FIFA TALENT ACADEMY KOSOVA', NJË HAP I MADH PËR ZHVILLIMIN E TALENTEVE TË RINJ

PRISHTINË, 2 SHTATOR - Futboli i Kosovës ka shënuar një tjetër moment të rëndësishëm në rrugëtimin e tij të zhvillimit, me inaugurimin zyrtar të "FIFA Talent Academy Kosova", një projekt i realizuar në bashkëpunim ndërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) dhe FIFA-s, i cili synon të krijojë mundësi të reja për identifikimin, zhvillimin dhe avancimin e talenteve të rinj. Ceremonia inauguruese ka mbledhur në një vend përfaqësues të FIFA-s, drejtues të FFK-së, përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, trajnerë, prindër, futbollistë e futbolliste të reja, si dhe figura të rëndësishme të futbollit të Kosovës dhe të gjeneratës së artë.

Hapja e kësaj akademie përfaqëson një investim të drejtpërdrejtë në gjeneratat e reja dhe në të ardhmen e futbollit të Kosovës, duke u ofruar fëmijëve mundësi për t'u zhvilluar në një ambient profesional dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

Ademi: 'FIFA Talent Academy', dëshmi e besimit të FIFA-s në Kosovë

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, në fjalën e tij ka vënë në pah rëndësinë historike të inaugurimit të akademisë dhe besimin e madh që FIFA ka treguar ndaj FFK-së dhe potencialit të futbollit të Kosovës. Ai ka theksuar se akademja do të ketë për mision nxjerrjen e gjeneratave të reja të futbollistëve dhe futbollisteve, të cilët në të ardhmen mund të bëhen pjesë e Kombëtares së Kosovës dhe të klubeve që e përfaqësojnë vendin në arenën ndërkombëtare. "Sot është një ditë e veçantë për Kosovën për faktin që sot në po inaugurohet 'FIFA Academy', e cila do të nxjerrë futbollistë dhe futbolliste tek këto troje, tek ky vend, të cilët një ditë sigurisht ndonjëri prej këtyre futbollistëve dhe futbollisteve do ta veshë fanellën e kombëtares sonë të Republikës së Kosovës", ka thënë Ademi.

Ai ka shprehur bindjen se nga kjo akademi do të dalin talente që do t'i bashkohen gjeneratës së artë të futbollit të Kosovës, duke iu referuar futbollistëve që tashmë kanë shkruar historinë e futbollit të Kosovës. Një rëndësi të veçantë në fjalën e tij i pari i FFK-së ia ka kushtuar pozitës së Kosovës në kuadër të këtij projekti të FIFA-s. Sipas tij, "FIFA Academy" në Kosovë është e para në rajon dhe Ballkan, e treta në Evropë dhe e 15-ta në botë, në kuadër të 211 federatave anëtare të FIFA-s.

Presidenti Ademi ka vlerësuar

këtë si një dëshmi të besimit të madh të FIFA-s në FFK-në dhe në potencialin që ka Kosova për zhvillimin e talenteve. Ai ka theksuar se përkundër sfidave që Kosova ka pasur ndër vite në aspektin e infrastrukturës dhe kushteve të punës, vendi ka një potencial të jashtëzakonshëm njerëzor. "Për fatin e mirë ne e kemi talentin, për çka na kanë lakmi pothuajse të gjithë, sepse fëmijët tanë janë fëmijët më të shëndoshë, më të bukur dhe më të përkushtuar në botë", ka thënë Ademi.

Në këtë kontekst, Ademi ka falënderuar veçanërisht prindërit për përkushtimin e tyre në edukimin dhe mbështetjen e fëmijëve, duke theksuar se "FIFA Talent Academy" nuk synon vetëm zhvillimin e aftësive futbollistike, por edhe edukimin përmes disiplinës, bashkëpunimit dhe respektit. Ai ka nënvizuar se fëmijët pjesëmarrës në akademi vijnë nga klube të Kosovës, duke e cilësuar punën e klubeve si një nga bazat kryesore mbi të cilat po ndërtohet zhvillimi i futbollit në Kosovë. Sipas Ademit, përpunimi i klubeve në garat evropiane dhe puna e tyre me gjeneratat e reja kanë ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e nivelit të futbollit në Kosovë.

Presidenti i FFK-së ka shprehur mirënjohje të veçantë për FIFA-n dhe drejtuesit e saj, duke përmendur presidentin Gianni Infantino, shefin e zhvillimit Arsene Wenger dhe drejtorin për Evropën, Elkan Mammadov, për mbështetjen e dhënë në realizimin e këtij projekti. Ai i ka falënderuar përfaqësuesit e FIFA-s dhe stafin teknik që kanë qenë të angazhuar në zhvillimin e akademisë.

Në fund të fjalës së tij, Ademi u është drejtuar drejtpërdrejt akademistëve të rinj, duke i inkurajuar ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe të synojnë të bëhen pjesë e gjeneratave të ardhshme të arta të Kosovës. "Jeni akademistët e parë të një akademie, madje jo vetëm në Kosovë, por të një akademie të parë në rajonin tonë. Prandaj sigurisht që jeni të artë qysh tash", ka thënë Ademi.

Gashani: Investim në potencialin e të rinjve dhe në të ardhmen e sportit

Në ceremoninë inauguruese foli edhe ministri në detyrë i Sportit i Republikës së Kosovës, Blerim Gashani, i cili e ka vlerësuar hapjen e "FIFA Talent Academy" si një moment të rëndësishëm për futbollin dhe sportin kosovar në përgjithësi. Ai ka thënë se akademja përfaqëson një hap të rëndësishëm në zhvillimin e futbollit. "Kjo akademi është një

hap përpara në zhvillimin e futbollit dhe përfaqëson një investim në potencialin e të rinjve tanë, në profesionalizmin e sportit dhe në krijimin e mundësive që talentët e Kosovës të zhvillohen sipas standardeve më të larta ndërkombëtare", ka thënë ai.

Gashani ka përgëzuar FFK-në dhe FIFA-n për bashkëpunimin dhe përkushtimin e treguar për realizimin e këtij projekti. Ai ka theksuar se fakti që Akademia e Talentëve të FIFA-s në Prishtinë është funksionale që nga fillimi i këtij viti dhe tash po inaugurohet zyrtarisht, dëshmon se në Kosovë po ndërtohet një sistem gjithnjë e më i strukturuar për identifikimin dhe zhvillimin e talenteve.

Ministri i Sportit e ka konsideruar veçanërisht të rëndësishëm faktin që Kosova është bërë pjesë e vizionit të FIFA-s për zhvillimin e talenteve në mbarë botën. Ai ka vënë në pah ambicijen që çdo fëmijë i talentuar, pavarësisht ku jeton në Kosovë, të ketë mundësi të identifikohet, të zhvillohet dhe të mbështetet përmes një sistemi profesional. Në këtë drejtim ai e ka konsideruar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, federatave sportive dhe organizatave ndërkombëtare si FIFA, thelbësor për krijimin e strukturave të qëndrueshme dhe rezultateve afatgjatë.

Duke iu drejtuar drejtpërdrejt futbollistëve dhe futbollisteve të rinj, Gashani i ka inkurajuar ata ta shfrytëzojnë këtë mundësi, të punojnë me përkushtim, t'i respektojnë trajnerët dhe bashkëlojtarët dhe të mos kenë frikë të vendosin synime të mëdha. "Kosova mund të jetë një vend i vogël, por talenti dhe ëndrrat e të rinjve tanë nuk kanë kufij", ka thënë ai.

Gashani ka thënë se detyra e institucioneve është të krijojnë kushtet dhe mundësitë, ndërsa detyra e të rinjve është që përmes punës, disiplinës dhe përkushtimit këto mundësi t'i shndërrojnë në suksese.

Danilevicius: Kosova, e para në Evropë me akademi për djem dhe vajza

Konsulenti teknik rajonal i FIFA-s, Tomas Danilevicius, ka vlerësuar lart punën e bërë nga FFK-ja gjatë dy viteve të fundit në kuadër të Talent Development Scheme, duke theksuar se Kosova tashmë ka arritur një pikë të rëndësishme në zhvillimin e këtij projekti. Ai ka thënë se vetëm dy vjet pas përfshirjes së Kosovës në program tani mund të flitet me krenari për krijimin e mundësive për të gjithë talentet e rinj, ndërsa theksoi pozitën e veçantë që ka Kosova në Evropë



dhe në botë. "Mund të themi se sot, në vitin 2026, vetëm dy vjet më vonë, mund të jemi krenarë se të gjithë djemtë dhe vajzat në Kosovë do ta kenë mundësinë të zhvillohen. Siç e përmendi edhe presidenti Ademi, kjo është akademja e tretë e këtij lloji në Evropë dhe e 15-ta në botë. Por, zoti President, do të thosha se Kosova është e para në Evropë që e ka akademinë edhe për djem edhe për vajza", ka thënë ai.

Danilevicius ka vënë në pah se ky është një moment i rëndësishëm jo vetëm për FFK-në, por për të gjithë futbollin e Kosovës, pasi mundësia për zhvillimin e talenteve po zgjerohet te të dyja gjinitë. Ai e ka konsideruar këtë arritje si dëshmi të punës së përbashkët ndërmjet FIFA-s dhe FFK-së, duke nënvizuar se akademja është vetëm hapi i parë i një procesi që pritet të sjellë rezultate të rëndësishme në vitet e ardhshme.

Më pas, Danilevicius ka theksuar se synimi është që "FIFA Talent Academy Kosova" të shndërrohet në një pikë referimi për rajonin, duke besuar se përvoja e Kosovës mund të shërbejë si model edhe për federatat e tjera të Ballkanit.

Danilevicius ka falënderuar edhe prindërit, trajnerët dhe futbollistët e rinj, duke u uruar këtyre të fundit një të ardhme të ndritur dhe duke shprehur dëshirën që gjenerata e re të arrijë edhe më shumë sesa gjenerata e artë e futbollit të Kosovës.

Ai e ka mbyllur fjalën me një mesazh optimist për të ardhmen.

Vidarsson: Hapi i radhës, zhvillimi i trajnerëve dhe identifikimi i talenteve

Në ceremoninë inauguruese ka folur edhe përfaqësuesi tjetër i FIFA-s, përgjegjës për Kosovën, Arnar Vidarsson, i cili është ndaluar te hapat e ardhshëm të "Talent Development Scheme" në Kosovë. Ai e ka cilësuar inaugurimin si një ditë krenarie për FFK-në dhe theksoi se puna e bërë deri tani është vetëm fillimi i një procesi më të gjerë.

Vidarsson ka bërë me dije se në muajt e ardhshëm projekti do të hyjë në një fazë të re zhvillimi, ku një rol të rëndësishëm do të ketë përdorimi i teknologjisë në procesin e identifikimit dhe monitorimit të talenteve. Sipas tij, tashmë ka nisur përgatitja për instalimin e kamerave video, përmes të cilave do të regjistrohen stërvitjet dhe ndeshjet e futbollistëve e futbollisteve të përfshirë në projekt.

Këto të dhëna, sipas Vidarsson, do të ndihmojnë në ndërtimin e një strategjie më të avancuar për identifikimin e talenteve, por edhe në zhvillimin e programeve për edukimin e trajnerëve. Ai ka përmendur edhe nisjen e kursit për UEFA Pro Licence në Kosovë, duke e cilësuar atë si një tjetër hap të madh në zhvillimin profesional të futbollit në vend. Vidarsson ka vlerësuar edhe punën e bërë në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet FIFA-s dhe FFK-së, përfshirë punëtoritë e zhvilluara gjatë muajve të fundit, të cilat synojnë forcimin e mëtejshëm të këtij partneriteti.

Ai ka shtuar se gjatë vizitave të tij në Kosovë ka parë se talenti nuk është vetëm në fushë, por edhe në strukturat që punojnë rreth futbollit. "Çfarë duam të krijojmë me këtë projekt është të trajnojmë më të mirët me më të mirët dhe kjo është diçka që po e shohim këtu në Kosovë", ka thënë ai, duke falënderuar presidentin e FFK-së, Agim Ademi, për lidhshmërinë e vizionit e tij në nisjen e këtij projekti, si dhe sekretarin e përgjithshëm Markus Weidner, trajnerin Rainer Kraft dhe gjithë stafin teknik që është i angazhuar çdo ditë me futbollistët dhe futbollistët.

Inaugurimi i "FIFA Talent Academy Kosova" shënon një etapë të re në procesin e zhvillimit të futbollit të moshave në vend. Përmes këtij projekti, FFK dhe FIFA synojnë që talentet e reja të kenë qasje në një sistem të organizuar të identifikimit, zhvillimit dhe monitorimit, duke krijuar një bazë më të fortë për gjeneratat e ardhshme të futbollit të Kosovës.

DEBAT PUBLIK

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftësat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftësat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasher” Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftësat dhe diplomën Q K “11 Marsi” Prizren.
- Trim Rezniqui shpall të pavlefshme dëftësën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftësën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftësat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftësat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermier, Bachelor me nr. 104.
- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftësat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftësën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftësën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftësën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

